



Qendra "Konsumatori Shqiptar"
L. 11, Rr. Kumini, Pall. 1319 Durrës,
Albania

Durrës, më 10.10.2025

KËRKESË PËR INFORMACION

Drejtuar: Z. Rrok Dodaj,
Kryetar,
Bashkia Pukë

Përgatitur nga: Qendra "Konsumatori Shqiptar"

Objekti: Kërkesë për informacion në lidhje me Zyrën e Mbrojtjes së Konsumatorëve pranë Bashkisë

I nderuar Z. Dodaj!

Ju urojmë të jeni mirë me shëndet dhe punë. Ju urojmë suksese në punën tuaj.

Qendra "Konsumatori Shqiptar" është një organizatë jofitimprurëse e krijuar në 2014 dhe ka si qëllim kryesor mbrojtjen dhe mbështetjen e konsumatorëve shqiptarë. Qendra është një nga organizatat e licensuara nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore falas. Aktualisht, Qendra po zbaton projektin **SAFECons** - "Shoqëria Civile në Veprim për përpjekje të koordinuara për Sigurinë Ushqimore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit" së bashku me ANTTARC, me mbështetjen e Bashkimit Evropian.

Një nga aktivitetet kryesore është monitorimi dhe nxitja e njësive të vetëqeverisjes vendore në lidhje me **Zyrat për Mbrojtjen e Konsumatorëve (ZMK)**, në përputhje me Ligjin nr. 130/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, si dhe Ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve", i ndryshuar.

Për sa më sipër, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, ju lutem na informoni në lidhje me:

- 1. A është ngritur dhe funksionon pranë Bashkisë Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve? Nëse po, ju lutemi bashkëngjisni vendimin përkatës të Këshillit Bashkiak. Cili është viti që është krijuar kjo strukturë?*
- 2. Cila është struktura përkatëse e ZMK-së në institucionin tuaj? Ju lutem bashkëngjisni organigramën ose aktin përkatës.*
- 3. Cilat janë funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e ZMK-së ose nënpunësit përkatës? Ju lutem bashkëngjisni rregulloren ose aktin përkatës.*
- 4. Cili është formimi arsimor i nënpunësit ose stafit të kësaj strukture? A janë trajnuar personat përgjegjës? Nëse po, çfarë trajnimesh kanë kryer? Ju lutem bashkëngjisni dokumentacionin përkatës.*

5. Cilat janë aktivitetet që ka realizuar kjo strukturë në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve? Ju lutem bashkëngjisni ndonjë foto, ose link.



Qendra "Konsumatori Shqiptar"
L. 11, Rr. Kumini, Pall. 1319 Durrës,
Albania

6. A keni trajtuar ankesa nga konsumatorët? Nëse po, cila është procedura e trajtimit dhe ndjekjes së këtyre ankesave? A keni një formular ose rregullore të miratuar? Nëse po, Ju lutem bashkëngjisni dokumentat respektivë.
7. A keni dijeni për detyrimin për raportim në lidhje për mbrojtjen e konsumatorëve në kuadër të procesit të integritetit? A është caktuar personi përgjegjës? Nëse po, Ju lutem bashkëngjisni dokumentat respektivë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj, jemi në pritje të përgjigjes suaj.

Për lehtësi komunikimi:

Email: qksh@qksh.org

Cel: 068 948 3303

Me respekt,
Prof. As. Dr. Ersida Teliti

Drejtore Ekzekutive,
Qendra "Konsumatori Shqiptar"

